



# Objektivat e Zhvillimit të Brendshëm

**Mirësevini!** Ky është një prezantim për të mësuar më shumë mbi platformën e zhvillimit personal Inner Development Goals - Objektivat e Zhvillimit të Brendshëm.

*Objektivat e Zhvillimit të Brendshëm (IDGs) është një organizatë jofitimprurëse dhe një komunitet aktiv me burim të hapur informacioni, ku njerëzit përdorin teknologjinë për të dhënë kontribute domethënëse për një të ardhme ku njerëzimi dhe planeti të zhvillohen e lulëzojnë së bashku. Ne hulumtojmë, mbledhim dhe komunikojmë aftësi dhe cilësi të bazuara në shkencë që na ndihmojnë të jetojmë jetë të qëllimshme, të qëndrueshme dhe produktive. Ky kuadër është thelbësor për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm - SDG.*

Çfarë janë Objektivat e Zhvillimit të Brendshëm?

Pikënisja

Lindja e një ideje

Realizimi i idesë

Një përshpejtues për Objektivat Globalë

Ku jemi

Si u zhvillua nisma

Lajm me rëndësi

Zhvillimi i Qëndrueshëm në Shqipëri - SDG

Si mbërritën IDG në Shqipëri

Bashkëpunime

Bëhuni bashkë-krijues të IDG - Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm

# Çfarë janë Objektivat e Zhvillimit të Brendshëm?

## Pikënisja

Në vitin 2015, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm ose [Sustainable Development Goals](#), na pajisën me një plan gjithpërfshirës për një botë të qëndrueshme brenda 2030. **17 objektivat** mbulojnë një rreth të madh problematikash, të cilat prekin njerëz me nevoja, vlera dhe ambicie të ndryshme anembanë globit.

Por progresi është i ngadaltë, ndaj dhe lindën pyetjet:

Si mundemi Ne ta përshpejtojmë këtë proces për njerëzimin? Çfarë mundemi Ne si individë dhe organizata të përmirësojmë për të qënë më efektiv në punën drejt qëndrueshmërisë dhe mirëqenies më të madhe?

Fatmirësisht, hulumtimet moderne tregojnë se aftësitë e brendshme për të cilat kemi nevojë tani mund të zhvillohen. Kjo ishte pikënisja e nismës së Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm – IDG.

Shih [këtu](#) faqen zyrtare të programit.



## Lindja e një ideje

Zhvillimi vetjak është treguesi kryesor i ndryshimit shoqëror. Prandaj, zgjedhja ishte si e dukshme ashtu edhe shumë frymëzuese – *të eksplorosh krijimin e një seti objektivash për zhvillimin e brendshëm, i cili mund të përdoret nga çdo komunitet, organizatë, ent dhe në mënyrë individuale.*

Viti 2019 shënoi lindjen e idesë për krijimin e Objektivave botërore të Zhvillimit të Brendshëm ose Inner Development Goals.

OzhB-IDG përfaqësojnë mençurinë e të gjithë brezave e kulturave, duke hulumtuar, mbledhur dhe komunikuar aftësi dhe cilësi të bazuara në shkencë që na ndihmojnë të jetojmë jetë të qëllimshme, të qëndrueshme dhe produktive. Ambicia është që këto mjete të përhapen në mbarë botën dhe t'i bëjmë ato po aq të famshme sa Objektivat Globale.

## Realizimi i idesë

Objektivat e Zhvillimit të Brendshëm u përmend për herë të parë në Konferencën Dixhitale [MindShift](#) në Stockholm School of Economics në Maj 2020.

Në punën drejt Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm, miliona njerëz dhe ekspertë u pyetën mbi problematikat më të rëndësishme për ta. Të frymëzuar nga procesi përfshirës, filloi formulimi i pyetjeve me rëndësi për anketimet. Prej tyre u mbledhën shumë të dhëna mbi aftësi dhe cilësi që janë më të rëndësishmet për të punuar në mënyrë efektive drejt **Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm - SDG**.

Një vit më vonë, u realizua drafti i parë i kornizës së OzhB-IDG. Reagimet dhe rishikimet u mbledhën në mënyrë dixhitale e mbi to, u formuluan emrat e kategorive. U sigurua që OzhB-IDG do të ishin të arritshme dhe të lehta për t'u kuptuar, me synimin për t'i bërë këto objektiva të zhvillimit vetjak, po aq të famshme sa Objektivat Globalë - SDG.

## Një Përsheptues për Objektivat Globalë

Forca kryesore shtytëse e projektit vjen nga të kuptuarit se bota nuk po ndryshon aq shpejt sa për të arritur [17 Objektivat Globalë](#). E meqë bota është pasqyrim i njerëzimit - puna më e rëndësishme fillon me veten. Fuqia e zhvillimit personal është e domosdoshme për përballimin e të gjitha sfidave me të cilat përballet njerëzimi.

**Qëllimi** i IDG është **të edukojë, frymëzojë dhe fuqizojë** njerëzit që të jenë një forcë pozitive ndryshimi në shoqëri si **lider** dhe të gjejnë një mënyrë më të qëllimshme për të parë çdo sfidë.

IDG-të ofrojnë një kornizë thelbësore të aftësive transformuese për zhvillim të qëndrueshëm, një platformë në terren se si të zhvillohen këto aftësi të nevojshme. [Korniza aktuale e IDG-ve](#) përfaqëson 5 dimensione dhe 23 aftësi dhe cilësi që janë veçanërisht të rëndësishme për udhëheqësit që trajtojnë SDG-të, por në thelb për të gjithë ne! Kjo është një metodë përsheptuese për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për të krijuar një të ardhme të begatë për mbarë njerëzimin.

# Ku jemi

Ju falënderojmë për interesin e shfaqur deri këtu dhe kohën që po i jepni këtij informacioni!



## Si u zhvillua nisma

Nisma e IDGs ka bashkë-krijimin në qendër të saj me zhvillim të vazhdueshëm dhe kontribut nga gjithnjë e më shumë ekspertë, shkencëtarë, praktikues dhe 23 organizata anembanë botës. Në vitin 2021 u publikua raporti i parë i IDGs që shpjegon sfondin, metodën dhe kornizën me 5 dimensione dhe 23 aftësi transformuese.

Deri më tani janë zhvilluar tre konferenca MindShift - Growth that Matters me 3000+ pjesëmarrës aktivë në total.

Në 29 Prill 2022, u zhvillua samiti i parë mbi IDG, duke bashkuar mbi 4000 pjesëmarrës nga 60 shtete – duke e bërë këtë një lëvizje botërore. Duke mbledhur lider intelektualë dhe ekspertë botërorë nga bota akademike dhe sektori i biznesit, u arrit një dialog ndërveprues mbi kuptimin e zhvillimit personal dhe si IDG-ja ndihmon në përsheptimin e Objektivave Globalë.

## Lajm me rëndësi

### **IDGs recommended in the EU Parliament report on SDGs**

The Inner Development Goals initiative has been recommended as an important framework to achieve SDGs in the European Parliament resolution of 23 June 2022 on the implementation and delivery of the Sustainable Development Goals.

Section 50 of the report says: "Underlines the importance of SDG 17 (partnerships for the goals); notes, in the framework of global partnerships and capacity building, the innovative role of open-source initiatives, such as the Inner Development Goals initiative, that aim to educate, inspire and empower people to be a positive force for change in society, thereby accelerating progress towards achieving the SDGs".

**Nisma e Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm - IDG është rekomanduar si një metodë e rëndësishme për arritjen e SDG-ve në rezolutën e Parlamentit Evropian të 23 qershorit 2022 mbi zbatimin dhe realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm - SDG.**



## **Zhvillimi i Qëndrueshëm në Shqipëri - SDG**

### **Shqipëria në Raportin e Zhvillimit të Qëndrueshëm për vitin 2022**

Indeksi i Zhvillimit të Qëndrueshëm për vitin 2022, u publikua nga “Cambridge University” me mbështetjen e agjencive të OKB-së. Në këtë raport Shqipëria renditet në vend të 61 mes 163 vendeve të tjera. Krahasuar me publikimin e vitit 2021, vendi ynë shihet të jetë përmirësuar me 3 pozicione, por përsëri gjendemi mes vendeve të cilat nuk kanë bërë progres të mjaftueshëm në arritjen e qëllimeve për një zhvillim të qëndrueshëm.

Raporti tregon se nga 17 objektiva gjithsej, në disa prej tyre vendi ynë ka qenë në rrugën e duhur, ndërsa në disa të tjera nuk regjistron progres.

Shih [këtu](#) Raportin e plotë.

## **Si mbërritën IDG në Shqipëri**

Prezantimi i parë i Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm – IDG në Shqipëri është realizuar nga Network Tribe Agency për sektorin bankar shqiptar.

Më tej, në gusht 2022 u hap thirrja e programit të parë të zhvillimit të lidershit – Global Leadership Programme, për të përshpejtuar punën e sektorëve dhe organizatave drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm - SDG, përmes aftësive transformuese për zhvillimin personal. Programi Global Leadership for Sustainable Development synon të frymëzojë, zhvillojë dhe lidhë +100 liderë nga vende e rajone të ndryshme të botës, të përfshirë në çështje të qëndrueshmërisë-sustainability në sektorë të ndryshëm të shoqërisë në Shqipëri, Kolumbi, Ruandë, Kosta Rikë, Indi dhe Zambia.

Takimi i parë i këtij programi u zhvillua në Kigali, Ruandë në Nëntor 2022 dhe do të vazhdojë me sesione online dhe takime lokale gjatë vitit 2023, duke ndihmuar anëtarët pjesëmarrës të përshpejtojnë punën e tyre me zhvillimin personal drejt 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, në vendet e tyre. Punëtorja në Kigali ishte gjithashtu pjesë e Konferencës Globale Shkencore mbi Human Flourishing nga TWCF dhe ishte një nga nëntë seminarët që priten në të gjithë botën.

Në Kigali, vendi ynë përfaqësohej nga Znj. Miriam Shyti dhe Znj. Ornela Sulçe – Network Tribe, midis 22 pjesëmarrësve nga bota për të ndarë dhe mësuar nga njëri-tjetri rreth zhvillimit personal dhe qëndrueshmërisë, për të diskutuar mbi kornizën IDG dhe për të nisur qendra kombëtare e vazhduar punën me IDG.

Organizatorët: IDG, Inner Green Deal, financuar nga Fondacioni Templeton.

## Bashkëpunime

*The IDGs Toolkit – Inner development approaches*

*Mindfulness-based interventions*

*Leadership development and practice*

*Adult development-based approaches*

*Group, team and family-based methods*

*Organizational and values-based methods*


*Sustainability science-based approaches*

*Systems thinking and complexity theory*

*Spiritual transpersonal approaches*

*Embodiment-based*

*Trauma-work*



## Dëshironi të bashkëpunoni me këtë nismë?

Për të mësuar më shumë mbi forma bashkëpunimi me IDG në Shqipëri, na kontaktoni në:

- Albanian IDG Centre - National Coordinator -  
[idginalbania@gmail.com](mailto:idginalbania@gmail.com)
- [Network Tribe](#)

Miriam Shyti  
Tel: +355698622076

## Partnerë dhe Mbështetës të Iniciativës

**Me rëndësi:** Disa pjesëmarrës nga institucionet, organizatat dhe aktorët e mëposhtëm që kanë shprehur mbështetje për programin. Pjesëmarrës nga:

*Embassy of Sweden in Albania*

*AADF*

*Albanian University*

*Auleda- Local Economic Development Agency*

*AZ Group*

*Barleti University*

*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë*

*Dhoma Ekonomike e Gruas*

*Dua Center*

*DMO Albania*

*European University of Tirana*

*Helvetas Swiss Intercooperation, RisiAlbania*

*InSET*

*NetworkTribe*

*Orion Construction*

*UNDP*

## Bëhu bashkë-krijues i Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm në Shqipëri?

Për të mësuar më shumë mbi forma bashkëpunimi me IDG në Shqipëri, na [kontaktoni](#):

OzHB-IDG sjell fuqinë e zhvillimit personal në të gjitha sfidat organizative, shoqërore dhe globale. Si bashkëkrijues dhe partner, ju do të:

- Keni akses tek mjetet dhe metodat që avancojnë kreativitetin dhe bashkëpunimin brenda organizatës suaj.
- Merrni ekspozim dhe bashkëpunoni me një rrjet kompanish dhe organizatash progresive që i japin përparësi zhvillimit personal dhe qëndrueshmërisë.
- Përshejtoni punën drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe krijoni angazhim për punën e qëndrueshme të organizatës suaj përmes zhvillimit njerëzor.
- Mësoni dhe punoni me disa nga udhëheqësit e mendimit dhe shkencëtarët më të famshëm në botë. Pjesëmarrje në eventin e Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm - IDG.
- Bashkë-krijoni paketën IDG në terren duke promovuar zhvillimin personal dhe qëndrueshmërinë.

*The Inner Development Goals is a scientific research project run together by the organizations Ekskåret Foundation ([ekskaret.se](http://ekskaret.se)), 29k ([29k.org](http://29k.org)) and The New Division ([www.thenewdivision.world](http://www.thenewdivision.world)). **The project leader is:** Jan Artem Henriksson. **The Method leader of the first phase is:** Thomas Jordan. **The method leader of the second phase is** Kristian Stålné, **the Co-lead is** Stefanie Greca.*

**Academic partners are:** Stockholm University, Stockholm School of Economics, Center for Social Sustainability at Karolinska Institute, Lund University Centre for Sustainability Studies (LUCSUS), Rotterdam School of Management of Erasmus University (for the current status of the partners, please also have a look at our website). For the current status of the collaborating **partners**, please also have a look at our website.